

KËRKIME GJUHËSORE

Fitor OLLOMANI

ABSTRAKSIONI¹ SEMANTIK NË PROCESIN E METAFORIZIMIT NË POEZINË E DIN MEHMETIT

Procesi i abstraksionit semantik ngërthen një problematikë komplekse të emërimit dhe ligjërimit gjuhësor. Kjo problematikë është aq e lashtë sa edhe vetë gjuha. Natyrisht, qasja që i bëhet këtij procesi ka ndryshuar në kohë, vende të ndryshme dhe në ligjërime të ndryshme.

Për të zbuluar natyrën e vërtetë të zhvillimit semantik të fjalëve dhe strukturave ligjëruese duhet të fillojmë nga lidhjet e para mes fjalëve drejt strukturave më të larta.

Marrëdhëniet semantike të fjalëve krijohen në rrjedhën linear të ligjërimit, të cilët krijojnë struktura sintaksore të niveleve të ndryshme në procesin e ligjërimit; ato lindin në strukturat minimale, në të cilat fillon abstraksioni semantik². Në varësi të ligjërimit krijohen struktura ku abstraksioni semantik është më i madh ose më i vogël. Në ligjërimin normal, strukturat e krijuara mes fjalëve nuk krijojnë mundësi të mëdha të abstraksionit semantik, ndërkohë në ligjërimin poetik ndodh e kundërta. Për të parë këtë proces kompleks dhe jetik për pasurimin semantik të gjuhës, jo pa qëllim, kemi zgjedhur poezinë e poetit Din Mehmeti.

Poezia e Din Mehmetit është një mundësi e madhe, ku mund të vështrohen sa më mirë marrëdhëniet semantike mes fjalëve, në të cilën strukturat ligjëruese kanë një mbështetje të madhe mbi bazën e marrëdhënieve metaforike.

Poezia e Din Mehmetit gjarpëron shtigjeve dhe rrugëve të një gjuhe të posaçme metaforike.³

Procesi metaforik është mundësia e artë e niveleve më të larta të abstraksionit semantik.

Procesi i abstraksionit semantik zë fill në strukturat minimale sintaksore të ligjërimit poetik⁴

Fjalët, jo vetëm që bartin aftësinë shenjuese, por ato kanë aftësi gjenerimi të lidhjeve semantike në funksion të shprehjes. Për të arritur nivelet e ndryshme të karakterizimit⁵ të realitetit, fjalëve u duhet më shumë forcë semantike. Kalimi në nivele të ndryshme emërtuese të fjalët është i kushtëzuar nga nevoja emërtuese e strukturave tona konceptore mbi botën që na rrethon.

¹ Sipas "Fjalorit të gjuhës shqipe", të vitit 1980, Abstraksioni ka të bëjë me largimin me anët e të menduarit nga vetitë, tiparet e lidhjet e ndryshme të sendeve e dukurive dhe dallimi, veçimi dhe përgjithësimi i tipareve të tyre më thelbësore, abstragim.

² J. Thomai, Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe (Semantike leksikore), EDFA, Tiranë, 2009, f. 142 -143.

³ D. Mehmeti, *Vepra letrare* 5; H, Mekuli, Tri shkrime, Drenusha, Prishtinë 2009, f. 07

⁴ Strukturat minimale ku ndodhin lëvizjet e para kuptimore.

⁵ Shprehjes.

Në këtë proces fjalët nuk mund të jenë të vetme madje kanë nevojë për mbështetje semantike të njëra-tjetrës. Mbështetja semantike mes fjalëve krijon kushte optimale për kalimin nga një nivel më i ulët abstragues semantik drejt një niveli më të lartë. Në lidhjet e para të fjalëve ndodh gërshetimi elementeve semantike të tyre. Lidhja e tyre është e kushtëzuar nga shumë faktorë të tillë si: natyra semantike, forma dhe rendi etj. Në studimet e ndryshme gjuhësore, sidomos në ato të gjenerativistëve është dëshmuar se marrëdhëniet semantike janë tepër përcaktuese në lidhjet mes fjalëve, në krijimin e njësive sintaksore dhe në transmetimin kuptimor tërësor të një teksti. Njësitë ligjërimore janë të ndërtuara nga struktura⁶ sintaksore të madhësive të ndryshme duke filluar nga struktura më të vogla dhe duke përfunduar në struktura më të mëdha. Në strukturat minimale sintaksore fillojnë fillesat e vërteta të marrëdhënieve semantike të fjalëve mes tyre, ku ndodh edhe lëvizja e parë kuptimore e fjalëve. Në këto struktura përmes aktualizimit të përbërësve të kuptimit për të emërtuar një nevojë të re për shprehje shkojmë drejt kuptimit të ri, i cili në fillim është kuptim figurativ dhe më pas kalon si pjesë e strukturës hierarkike kuptimore të fjalës⁷, përmes kalimit të kësaj strukture gjuhësore në vetëdijen gjuhësore kolektive. Poezia e Din Mehmetit na ofron një shumësi metaforash të krijuara në nivelet e sintagmave, ku shumë prej tyre janë bërë pjesë e vetëdijes kolektive gjuhësore, të tilla si: *drita shkurë e verdhë, gjuha e nxirë e tymit, piramidë pikëllimi, leqet e frikës, pesha e kohës, brerimë lotësh e gëzimesh, varr i një vjeshte, zemra e detit, flakadajt e fjalëve, pështymë e vjeshtës, frazë e fryrë, karriga e lakmive, baladë për frazën e fryrë, kodër konservash të prishura, shikime gjarpërinjsh, maska enguj, maska thikë*.⁸

Pra siç shihet ligjërimi poetic përjetëson procesin e metaforizimit edhe në nivel sintagmash, ku abstraksioni semantik është dhe mbetet në nivelet të larta. Natyrisht, lëvizjet kuptimore mes fjalëve nuk përfundojnë në strukturën e sintagmës, ato vazhdojnë dhe bëhen më të larmishme në strukturën e fjalisë. Prania e shumë elementeve leksiko- gramatikore krijon mundësi për marrëdhënie semantike më të mëdha, gjithnjë në funksion të komunikimit poetik.

Në ligjërimin poetik fjalët hyjnë në marrëdhënie të veçanta me njëra – tjetrën. Rendi normal i lidhjeve nuk qëndron i tillë. Shprishja e rendit normal të lidhjeve fillon që në gjenezën e sintagmës, natyrisht për qëllime stilistike. Nuk mungojnë edhe rastet kur kemi shprishje të natyrës formale të elementeve gramatikore. Një shprishje e tillë është konsideruar, mënyrë e veçantë ligjërimi e quajtur, si mënyrë metaforike e të shprehurit. Mënyrë të cilën e artikulon më së miri Din Mehmeti në poezinë e tij. Ja disa metafora të gjeneruara në nivel fjalish në poezinë e Din Mehmetit të tilla si:

Gjërat ecin pa këmbë, toka ngrihet lart, qielli bie poshtë, vras orën e haresës, këngë që u jep dritë syve, më përcjellin këto krisma, u poq fëmijëria ime,

⁶ Përdorimi i termit strukturë mund të shikohet si sinonimi i termit njësi sintaksore.

⁷ J. Lynos, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë, 2001, f. 376.

⁸ Din Mehmeti, *Vepra Letrare*, nr 1, ORA, Drenusha, Prishtinë, 2009, f. 200 – 220.

ABSTRAKSIONI SEMANTIK NË PROCESIN E METAFORIZIMIT NË POEZINË E DIN MEHMETIT

*lehin erërat, jeta po shkelmon, heroinë është fjala, dielli shkuli ferra, varret
nxorën eshtra, fjalët morën kokën, fjalët ... vrapuan.*

Mekanizimi mbi të cilin funksionon procesi i metaforizimit është një mekanizëm kompleks në të cilin është ngritur, rritur dhe jeton poezia e Mehmetit.

Metafora është mënyrë e të shprehurit me burim nga procesi i të menduarit dhe të konceptuarit të botës që na rrethon, të momenteve më të rëndësishme të jetës sonë. Kjo mënyrë e të menduarit dhe të konceptuarit nuk është thellësisht individuale, por nuk është as thellësisht kolektive duke përcaktuar në një farë mënyre një rreth në ngjashmërinë e këtij procesi. Marrëdhëniet semantike mes pjesëve përbërëse në një konstrukt metaforik shpeshherë janë të çuditshme, “të papranueshme” dhe të pamundura në rrjedhën e ligjërit normal.

Në strukturën e lidhjeve metaforike marrëdhëniet semantike janë të ndërtuara bazuar në parimin e besimit primar të krijuar mes “folësit” dhe “dëgjuesi”.

Ky besim buron nga ngjashmëria e proceseve perceptive dhe koncepteve mbi botën që na rrethon. Metafora është qendra e abstragimit semantik, përgjegjës për shprehjen e ndjesive më abstrakte të njeriut.

Fazat e metaforizimit janë shprehje e kalimit nga një figurë letrare në një figurë gjuhësore. Në fillim emërtimi i sendit të parë, prej të cilit emërtohet sendi i dytë, i lidh ngushtë të dy sendet, të cilët, me të përmendur emërtimin na vijnë ndërmend të dy⁹. Në këtë rast kemi një figurë të mirëfilltë letrare. Më tej përfytyrimi i dy sendeve shkëputet, largohen dhe përmendja e njërit nuk na sjell domosdo tjetrin. Atëherë emërtimi kthehet në figurë gjuhësore, për të dy sendet nuk ka emërtim tjetër, lind kështu një kuptim i ri gjuhësor.

Për këtë arsye, apo edhe për arsye të tjera, metafora ka të bëjë me dukurinë e polisemantizmit.

Poezia e Din Mehmetit është një univers në të cilin gëlojnë metaforat dhe abstraksioni semantik është në lulëzimin më të madh; ajo i ofron lexuesit imazhe që krijojnë shkëputje nga forca semantike fillestare e fjalëve duke e orientuar vëmendjen drejt niveleve të larta të abstragimit. Metaforat janë njësia bazë mbi të cilën janë ngritur të gjitha njësitë semantike të përcimit të asociacioneve që krijohen, ndjenjave që përcillen, imazheve që formohen në këtë lloj poezie.

Le të shikojmë mekanizimin e abstraksionit semantik në një nga metaforat të shumësishë metaforike në poezinë e Din Mehmetit.

I mllëfur fiku dritën/Ajo ëndërr. I mllëfur ndezi dritën/ Ajo zhgjandërr¹⁰


Për të kuptuar më saktë marrëdhëniet mes pjesëve përbërëse të vargjeve le të rindërtojmë rendin normal të ligjërit (neutral), *Ajo ëndërr/ i mllëfur fiku dritën.*

⁹Procesi i metaforizimit është proces universal, madje qëndron në thelb të emërtimeve fillestare të realitetit.


¹⁰ Din Mehmeti, *Vepra Letrare, nr 1, ORA*, “Flas diçka e s’them asgjë”, Drenusha, Prishtinë, 2009, f. 200.

Marrëdhëniet që krijohen në këtë strukturë ligjërimore mund t'i shikojmë në këto struktura më të vogla: *Ajo ëndërr/Ëndërr i (e) mllefur (Ajo) ëndërr/ Ajo enderr fiku dritën/ Fiku dritën*.

Le të shikojmë marrëdhëniet semantike të pjesëve leksikogramatikore në ligjërimin normal. Tre skemat e mëposhtme janë ndërtuar duke ndjekur rrjedhën kronologjike të lidhjeve mes pjesëve përbërëse të sintagmave dhe të sintagmave në vetvete.



Skema¹¹ nr. 1



Skema¹² nr 2

Në ligjërimin poetik marrëdhëniet mes pjesëve janë në lidhje të tilla, në të cilin lidhjet semantike kanë mbështetje të fortë nga lidhja të së njëjtës kokë në sintagmën e parë, pasi jo të gjitha ëndrrat e unit lirik kanë këtë cilësi. Në planin abstragues të leksemës “ëndërr” kemi: një dëshirë e zemëruar në shuarje. Kjo shuarje e kësaj dëshire vjen si rezultat i braktisjes së udhës së ndriçuar nga drita udhërrëfyese. Kalim kuptimor është bërë duke u bazuar në skemën: ëndërr > dëshirë për diçka që duam të na plotësohet në të ardhmen; dritë > udhërrëfyese, drejtimi, rruga që duhet të ndjekim për të realizuar dëshirat. Disharmonia formale na orienton drejt një mllefi femëror (e mllefur) me cilësi mashkullore. Në mbështetje të këtij mendimi mund të sjellim edhe rendin invers. Për fjalët kyçe të vargjeve, sipas “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” të vitit 1980, në strukturën poetike të mësipërme janë aktualizuar kuptimet jo të para, por kuptimet të figurshme, që krijojnë mundësinë e kuptimeve urë drejt zgjerimit të strukturave semantike.

Përkatësisht, për fjalën *dritë* janë aktualizuar kuptimi i 4-t dhe 6-të nga struktura kuptimore e përbërë nga 9 kuptime; për fjalën *ëndërr* është aktualizuar kuptimi i 3-të që është i fundit në strukturën hierarkike kuptimore të fjalës; për fjalën *fik- a, -ur*, është aktualizuar kuptimi i 2-të, i fundit në strukturën semantike

¹¹ Kjo skemë na jep mundësinë për të parë kokën semantike në lidhjet bazë të saj me pjesët e tjera të fjalisë, thënë ndryshe lidhjet semantike fillestare të fjalëve përbërëse të njësisë ligjërimore, tashmë të kthyer në një njësi ligjërimore normale, për të krijuar një ide sa më të qartë për lidhjet semantike.


¹² Skema nr. 2 na krijon mundësi për të parë lidhjet semantike tashmë si njësi përbërëse sintagmatike të rrjedhës ligjërimore, edhe këto lidhje janë të kushtëzuara nga boshhti semantik i fjalëve. Është hapi i tretë i lidhjeve semantike për të arritur në njësinë ligjërimore.

ABSTRAKSIONI SEMANTIK NË PROCESIN E METAFORIZIMIT NË
POEZINË E DIN MEHMETIT

hierarkike të fjalës; për fjalën *i (e) mllefur* është përdorur kuptimi i 2-të, nga tërë struktura semantike e përbërë nga dy kuptime.

Në këtë mënyrë, mund të pohojmë se, në struktura të tilla poetike, largimi nga kuptimi i parë është më i mundshëm, madje kemi tendence të dukshme drejt zgjerimit të strukturave semantike të këtyre fjalëve.

Në këto vargje struktura bazë e abstragimit është krijuar në raportin semantik:ëndërr – dritë. Nga ky kombinim mund të themi se fjala dritë del me një kuptim, që sot është kuptim urë si: (udhërrëfyese, guidë e lëvizjes së dëshirave në vorbullën e errët të tyre; fiku dritën > humbi rrugën, humbi drejtimin, u bë i paqartë). Ky kuptim, në këtë stad ligjërimit mbetet pa fituar pavarësinë e tij nga kuptimet prej nga ku buron dhe për të qenë anëtar i pavarur i strukturës semantike të fjalës *dritë* duke e zgjeruar strukturën e saj. Paraqitja skematike e lidhjeve semantike të leksemave të vargjeve të mësipërme mund të paraqiten si më poshtë:



Skema¹³ nr. 4

Poezia e Din Mehmetit është e mbarsur me metafora, që krijojnë mundësi për të vëzhguar gjithë mekanizmin e abstraksionit semantik në rrjedhe të kohës, mekanizmin kur strukturat metaforike bëhen pjesë e vetëdijes kolektive gjuhësore etj. Në këtë këndvështrim, metaforat konceptuale dhe të ngurosura janë tregues më i rëndësishëm i këtij procesi.

Mekanizmi funksional i tyre bart të vërtetën emërtuese dhe komunikuese të gjuhës në vetvete. Le të shikojmë mekanizmin e funksionimit të tyre në ligjërimit poetik të Mehmetit duke analizuar nga një shembull për secilin rast.

Edhe pak blerim / duan rrepëtimat e syve/ për ta përsëritur veten/ kur na pushton vetmia¹⁴

Në vargjet e mësipërme metafora e ngurtësuar “*na pushtoi vetmia*” në një kohë të papërcaktuar të së shkuarës ka patur statusin e një metafore të mirëfilltë, ku marrëdhënia semantike mes foljes *pushtoj* dhe emrit *vetmi* ka qenë e ndërtuar mbi bazën e konstruktit metaforik të përdorimit të figurshëm. Sot kjo strukturë mbetet metaforike me status të ngurtësuar, pasi kjo shprehje është e tillë në të gjithë vetëdijen gjuhësore të folësve të gjuhës shqipe. Mund të pohojmë se, bazuar në këtë strukturë janë ndërtuar shprehje të shumta të tilla si: *na kaploi vetmia*, *na mbyti vetmia* etj. Ajo që vihet re në të gjitha strukturat e mësipërme është raporti

¹³ Në skemën nr. 4 kemi paraqitur lidhjet semantike në ligjërimit poetik të poetit Din Mehmetit në vargjet e marra për analizë, shihet qartë lidhja semantike e shprehur përmes shigjetave dhe drejtimi përkatës, ndërsa lidhja lineare mes njësive sintagmatike dhe drejtimit i tyre është paraqitur përmes një vije të drejtë.

¹⁴ D. Mehmeti, *Vepra Letrare*, nr. 1, ORA, “*Pa dashuri*”, Drenusha, Prishtinë, 2009, f. 240.

sinonimik mes shprehjeve ndërtuar mbi bazën semantike të prezencës së vetmisë në shkallë të ndryshme. Struktura hierarkike semantike e foljeve: *pushtoj/i*, *kaploj/i*, *mbys/mbyti* është tregues i sinonimisë së pjesshme të strukturave metaforike të ndërtuara mes tyre dhe emrit *vetmi*. Si rezultat i sinonimisë mes tyre, marrëdhëniet kuptimore me kokën vetmi janë më të mundshme dhe më të lehta për t'u realizuar.

Në realizimin e lidhjeve semantike mes foljes *pushtoj* dhe emrit *vetmi* kemi aktualizmin e kuptimit të 6 – të (Më zë më kap tërësisht një ndjenjë , një mendim a një gjendje , më mbërthen të tërin, më bën për vete)¹⁵ të foljes *pushtoj*. Ky është tregues i rëndësishëm i shkallës së lartë të abstraksionit. Natyrisht, kjo marrëdhënie mbetet e tillë në tërë vetëdijen gjuhësore të folësve të shqipes. Mehmeti në poezinë e tij u jep jetë strukturave të tilla duke i bërë të perceptueshme vetëm në këtë mënyrë.

Metafora e ngurtësuar ka një lidhje organike me metaforën e konceptuale¹⁶, pasi kjo e fundit është fillesa e ngurtësimit të strukturave të tilla.

¹⁵ “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” botimi i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 1980, f. 1579.

¹⁶Baza e metaforës konceptuale është pjesë e zakonshme e aparatit konceptual të shpërndarë nga kujtesa kulturore. Metaforat konceptuale janë krijuar në raportin e lidhjeve mes strukturës konceptuale të sferës së njohjes dhe termave (fjalëve) emërtuese të kësaj pjese të kulturës. Metaforat konceptuale i kuptojmë vetëm në aspektin e përvojave të përbashkëta. Metaforat konceptuale janë të thjeshta (nuk përfshijnë pjesën e vetëdijes), edhe pse mund të tërheqin vëmendjen tonë. Operacioni i njohjes mbi to është pothuaj automatik. Metaforat konceptuale janë konvencionalizuar (shenjuar), gjerësisht në gjuhë; madje ekzistojnë një numër i madh fjalësh , kuptimi i të cilëve është në varësi të metaforave konceptuale. Kjo është mënyra përmes së cilës janë krijuar dhe ekzistojnë metaforat konceptuale. Thënë ndryshe, kuptimi metaforik i këtyre fjalëve është bërë pjesë e vetëdijes gjuhësore, vetëm në këtë mënyrë, duke i bërë të duken se ekzistojnë vetëm në këtë mënyrë. Dallimi mes metaforës konceptuale dhe metaforës komplekse ka të bëjë me lidhjet me burimin, që ekziston dhe mungon te njëra dhe tek tjetra. Në ligjërimin e përditshëm metaforat konceptuale përcjellin një koncept, i cili mund të perceptohet vetëm në këtë mënyrë dhe në asnjë mënyrë tjetër. Metaforat konceptuale shpeshherë janë ngurtësuar në fjalë të urta në ligjërimin popullor: shpirti nuk blihet me para, koha është flori, koha është e shenjtë, ju jeni jashtë kohe, shpenzova shumë kohë, humba shumë kohë, ju kushtova shumë kohë etj., këto metafora janë derivime të marrëdhënieve konceptuale në një kohë të largët, që gjë ka bërë të humbasin lidhjet me burimin prej së cilit kanë rrjedhur këto metafora.

Teoria e metaforës konceptuale refuzon idenë se metafora është mjet dekorativ periferik në gjuhë dhe mendim. Teoria e metaforës konceptuale mendon se metafora është në qendër të mendimit, rrjedhimisht edhe në qendër të gjuhës. Nga kjo pikënisje kanë rrjedhë disa parime , të cilët janë diskutuar veçanërisht me një referencë të veçantë gjuhësore. Këto parime janë:

1. Metafora është pjesë e strukturës së të menduarit. 2. Metafora është pjesë e strukturës së njohjes. 3. Metafora është qendra e pjesës abstrakte të gjuhës. 4. Metafora është rritur në eksperiencën fizike të jetës (përvoja jetësore).5. Metafora është pjesë e pjesës ideologjike e gjuhës.

ABSTRAKSIONI SEMANTIK NË PROCESIN E METAFORIZIMIT NË POEZINË E DIN MEHMETIT

Metafora konceptuale ka lidhje të ngushtë me trashëgimin kulturore të folësve të një gjuhe, ndaj ajo është pjesë e strukturave konceptuale të folësve të asaj gjuhe.

Shumë poezi të Din Mehmetit janë të ndërtuara mbi bazën e metaforave konceptuale, duke adresuar poezinë e tij për lexuesin njohës të trashëgimisë kulturore shqiptare. Një ndërtim i tillë i jep mundësi autorit që të jetë selektiv për lexuesin e tij. Ekziston një shumësi metaforash të ndërtuara mbi bazën e marrëdhënieve semantike të leksemës kohë dhe konceptit kohë në arealin shqiptar. Aty ku koha mbetet kohë, në të cilën toka është me zemër të madhe, kohë ku ditëlindjet e njerëzve janë në tym, pesha e kohës është e rëndë për shkak të rrethanave të veçanta. Në vetëdijen e shqiptarit koha nuk të lë të bëhesh kohë, pra nuk je kalimtar si koha fizike, por kërkon të jesh gjurmë në kohë.

Në historinë e shqiptarit koha merr një rëndësi të veçantë, sidomos e shkuara prej së cilës kemi të trashëguar historinë; e tashmja, që jetojmë në guaskën e mundimit; e ardhmja, në të cilën projektojmë jetën sipas këndvështrimit tonë dhe kushteve historike pasuese.

Nuk do të kishin kuptim metaforat e poezive “*S’më le koha të bëhem kohë*” dhe “*Dje sot e nesër*” nëse nuk do t’i referohemi strukturës konceptuale dhe kulturore të popullit shqiptar.

*Nuk kam kohë /As të qesh as të qaj; S’më le koha/ të bëhem kohë.*¹⁷

*Thikë e re në plagën e vjetër/ Në gotën e thellë/ Koha vidhte veten*¹⁸

Konstruktet metaforike *s’më le koha të bëhem kohë* dhe *koha vidhte veten* janë ndërtuar mbi bazën konceptuale dhe kulturore të vetëdijes së shqipfolësve. Ndërtime të tilla janë të adresuara që në gjenezë, kjo i bën të veçantë edhe në marrëdhëniet semantike, pasi koha në të cilën janë krijuar luan një rol vendimtar për dekodifikimin e tyre në të ardhmen, në horizontin e pritjes.

Ndërtimi i parë metaforik është i ndërtuar mbi bazën e dëshirës së kushtëzuar të unit lirik për të qenë pjesë e kohës, madje të përngjasojë dhe të ekzistojë si i tillë.

Pamundësia për të qenë kohë është e kushtëzuar nga vetë koha në të cilën jeton.

“Kuptimi i një sferë përmes termave, na çon drejt një sfere tjetër të fiksuar në lidhjet mes origjinës (i quajtur teknikisht hartë, planifikim semantik) dhe sferës së synuar më parë. Kjo strukturë e planifikimit (semantik) ekziston mes elementeve përbërëse të sferës së synuar.” Për të njohur metaforën konceptual duhet të njihet struktura e planifikimit semantik që është zbatuar për të dhënë dysinë burim – synim (burimi i synuar në aspektin semantik). Këto janë planifikime semantike që japin shumë kuptime të metaforës gjuhësore të shprehjes, ose thjeshtë të metaforës gjuhësore që krijojnë shfaqje të veçanta të metaforës konceptuale.

¹⁷ Din Mehmeti, Vepra Letrare, nr 1, Ora, “*S’më le koha të bëhem kohë*”, Drenusha, Prishtinë, 2009, f. 198.

¹⁸ Po aty, “*Dje sot e nesër*” f. 199.

Fjala kohë në ndërtimin metaforik *s'më le koha të bëhem kohë*, ka krijuar një shkëputje të madhe nga kuptimi i parë duke aktualizuar kuptimin e 12 – të të strukturës semantike të saj.

Në këtë strukturë fjala *kohë* ka kuptimin e kushteve, rrethanave objektive, që zhvillohen e që sjellin ndryshime që përfytyrohen si një forcë vepruese.

Për të arritur të dekodifikohet kjo strukturë nevojitet një orientim në kohë dhe hapësirë të lexuesit, natyrisht duke qenë njohës i mirë i “kohës” në të cilën është shkruar kjo poezi.

Duke analizuar këtë përfatesë të ligjërimit poetic, shikojmë një dëshirë ironike të poetit.

Ai nuk mund të jetë pjesë e kësaj kohe, nuk mund të bashkohet me atë që i ofron koha në të cilën jeton dhe kjo për shkak të kohës.

E gjithë marrëdhënia semantike është e bazuar në aktualizimin dhe rimarrjen e të njëjtë kuptim të fjalës kohë. Për të arritur tek thelbi i kuptimit të konstruktit poetic nevojitet një sistem njohjeje të mirë mbi kushtet historike, kulturore, rrethanave dhe mjedisit social në të cilat janë lindur dhe rritur tipe të tilla metaforash.

Edhe metafora e dytë, *koha vidhte veten*, është e ndërtuar mbi të njëjtën bazë marrëdhëniesh semantike. Një kohë që konsumon vetën; kushte historike, rrethana që nuk mund të qëndrojnë të tilla për shkak të natyrës që kanë.

Në rrethana të tilla abstraksioni semantik është, ekziston vetëm duke patur sistem referimi sistemin e njohjes mbi strukturat e njohjes, trashëgimisë konceptuale dhe kulturore.

Strukturat minimale sintaksore janë fillesat e para të marrëdhënieve semantike, në të njëjtën kohë fillesat e abstraksionit semantik; pa dyshim poezia e Din Mehmetit është një tregues i rëndësishëm për mekanizmin e këtij procesi.

Fjalja si njësisë bazë e ligjërimit është boshti i marrëdhënieve semantike, rrjedhimisht edhe boshti i abstragimit semantik, ndryshimit të strukturave kuptimore të fjalëve si shprehje e nevojës së komunikimit.

Poezia e Din Mehmetit bart mundësi të pafundme të abstraksionit semantik bazuar mbi mekanizmin e procesit të metaforizimit¹⁹ si baza e ligjërimit poetik. Ajo ngërthen shumë tipa metaforash duke filluar me metaforat me karakter absolut²⁰ (*fjalët morën kokën*), katakrezë (*në grykë të fushave*), konceptuale (*peshë*

¹⁹Bazuar në mekanizmin e paraqitur si në rastin e metaforave të trajtuara në shembullin e dhënë.

²⁰Përmbajtja e një metafore me “karakter absolut” nuk mund të jetë një përmbajtje e caktuar dhe e hollësishme. Metafora me karakter absolut mund të jetë e mundur vetëm në sajë të përdorimit të fjalëve metaforike (shumëkuptimshme). Në këtë rast, metafora nuk është gjë tjetër veçse një nga kuptimet e shprehjes, që është pjesë e tërësisë kuptimore të strukturës ligjëruese. Ulrich Baltzer mendon se: “Bashkëpunimi primar mes folësit dhe dëgjuesit është i bazuar në besimin e bashkëbisedimit që bart nënkuptime në transmetimin e kuptimit të fshehur, të nëndheshëm”. Metafora absolute buron nga një situatë primare, origjinale, e cila e thërret përvojën për të kujtuar krahasimin primar në një shfaqje jo të largët. Situata konkrete në të cilën shfaqet metafora, zë fill dhe zhduket gradualisht në

ABSTRAKSIONI SEMANTIK NË PROCESIN E METAFORIZIMIT NË
POEZINË E DIN MEHMETIT

e kohës), komplekse²¹ (*flakadajt e fjalëve*), metafora e ngurtësuar (*brerim lotësh e gëzimesh*) etj. Dhe si e tillë, ngërthen struktura semantike të ligjërit poetik që janë në fazë të ndërmjetme për t'u bërë struktura të ligjërit normal të tilla si: *zemra e detit, lehin erërat, shikime gjarpërinjsh, bebëza të dritareve, zingjirë të gjakut*.

Në përmbyllje, mund të pohojmë se shumë struktura metaforike të kësaj poezie janë pjesë e vetëdijes kolektive gjuhësore, të tilla si: *na pushtoi vetmia, në sytë e agimit, pesha e kohës, leqet e frikës etj.*

BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave, *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980.
A. Ayer, *Gjuha e verteta dhe logjika*, Tiranë, 2009.
A. Aliu, *Kthimi në burim*, në *Din Mehmeti, Vepra letrare nr. 1*, Prishtinë, 2009.
A. D. Jasiqi, *Poeti që vazhdimisht ka shënuar ngritje cilësore*, Prishtinë, 2008.
A. Martine, *Elementet e gjuhësisë së përgjithshme*, 1967.
B. Kroçe, *Estetika si shkencë e shprehjes dhe e gjuhësisë së përgjithshme*, Tiranë, 1998.
B. Muhadri, *Të jesh poet* (Dialog me Din Mehmetin), Gjakovë, 2006.
D. Mehmeti, *Ora*, Prishtinë, 1974.
E. Sapir, *Gjuha – Hyrje në studimin e ligjërit*, Prishtinë, 1980.
E. From, *Gjuha e Harruar*, Tiranë, 1998.
F. Arapi, *Mungesa e fjalës dhe heshtja e madhe*, Prishtinë, 1984.
F. Sausure, *Kursi i gjuhësisë së përgjithshme*, Tiranë, 2002.
G. Gafi, *Sintaksa* (strukturat e ligjërit), Tiranë, 2003.
I. Rugova, *Kritika*, Prishtinë, 2007.
I. Rugova, *Burimesia e një poezie*, Prishtinë, 1982.
H. Hagjosa, *Kulmi i figuracionit poetike modern* Prishtinë, 2004.
J. David Sapir. *The anatomy of metaphor in The social Use of Metaphor*, edited by J. David Sapir and J. C Crocker, University of Pennsylvania Press, 1977.

rëndësinë e lidhjes metaforike. Në strukturat metaforike emrat fillestarë treten në cilësimet mbiemërore. Metafora mund të ekzistojë në një nga imazhet e duhura, shpesh në ballafaqim me imazhe të tjera për të krijuar (përdorur) fjalë që krijojnë kalimin kuptimor nga realiteti në një bartje tjetër vetëm në distancë të madhe kohore. Metafora vjen si shprehje më e fortë se imitimi, ekziston një forcë e plotë në autonominë e figurës së të folurit (metaforës), nga shfaqja (momenti i shfaqjes) rrezatimi i pjesshme e kuptimit të pritësit (marrësit).

²¹ Metafora me karakter kompleks është e ndërtuar në lidhjet që ekzistojnë mbi bazën e eksperiencës së një populli, folës i një gjuhe të caktuar. Kulturat e popujve të ndryshëm janë kushtëzuese në mënyrën e të shprehurit të perceptimit të realitetit dhe të kulturës së tyre..

Çdo gjuhë ka të veçantën e saj semantike bazuar mbi lidhjet e eksperiencës së folësve të asaj gjuhe, ndaj dhe lidhjet semantike të figurshme janë të bazuara në lidhjet e eksperiencës jetësore dhe psiko - sociale të folësve të gjuhës përkatëse. Metafora komplekse ka një lidhje të ngushtë me konceptet dhe me strukturat konceptuale të sistemit të njohjes.

FITOR OLLOMANI

- J. Lynos, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Tiranë, 2001.
- J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, 2009.
- J. Thomai, *Mbi mënyrën e pasqyrimet të sistemit të kuptimeve dhe të përdorimeve të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe*, në Studime filologjike” 1964, 4.
- M. Pozzato, *Semiotika e tekstit*, Tiranë, 2005.
- M. Solar, *Hyrje në shkencën për letërsi*, Tiranë, 2001.
- N. Chomsky, *Gjuha dhe problemet e njohjes*, Tiranë, 2007.
- R. Musliu, *Mbindërtimi poetik*, Prishtinë, 1990.
- R. Barthes, *Aventura Semiologjike*, Dukagjin – Pejë, 2008.
- R. Frost, *Education by Poetry*, Amherst Garduates’ Qyarterly, Feb. 1931.
- Sh. Islamaj, *Gjuha, ligjerimi dhe fjala*, Prishtinë, 2004.
- Sh. Bali, *Gjuha dhe jeta*, Tiranë, 2006.
- U. Eco, *Në kërkim të gjuhës së përkryer*, Tiranë, 2008.
- Z. Kovecses, *Metaphor in Culture, Universality and Variation*, Cambridge University, Press 2005.